

VENDIM
Nr. 577, datë 3.10.2018

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 714, DATË 29.10.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR KUKËS–KRUMË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 714, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat si më poshtë vijon:
 - a) Pas tabelës së përmendur në pikën 3, shtohet tabela 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën 2 bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “Truall”, me sipërfaqe 161 m², me vlerë 321 839 (treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.”
 - c) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 si më poshtë vijon:

“4/1 Vlerës totale të shpronësimit, për pasurinë e llojit “truall”, i shtohet shuma 321 839 (treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë, e cilat do të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2018, zëri “Shpenzime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”
 - ç) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1 Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krumë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E SHPRONËSIMIT
ME NDRYSHIMET PËRKATËSE TË VLERAVE SIPAS LLOJIT TË PASURIVE NGA “ARË” NË “TRUALL” “KUKËS–KRUMË”

Shënim. Çmimet për truall janë marrë në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr. sipasVK M-së	Tabela e shpronësimit sipas VKM-së nr. 714, datë 29.10.2014										Nr.	Tabela e shpronësimit e ripunuar											
	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sip. e shpr.	Çmimi (m ²)	Vlera (lekë)		Pronari			Zona kad.	Nr. pas.	Sip. to-tale	Lloji i pas.	Sip. e shpr.	Çmi-mi lekë/m ² sipas VKM-së	Diferenca e çmimit nga “arë” në “truall”	Vlera në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									Emri	Atësia	Mbie-mri									
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
3	Hasan	Hysen	Peka	2282	2/58	1565	Arë	161	272	43792	1	Hasan	Hysen	Peka	2282	2/58	1565	Tru-all	161	2271	1999	321839	Konf. nga ZVRPP-ja
	SHUMA							161		43792									161			321839	